



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Administrimi publik**

Fakulteti	Shkencat Shoqërore Bashkëkohore
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	120
Kodi	N-MPAPAS120C
Titulli	Magjistër i administrimit publik
Numri në arkiv i akreditimit [120]	03-619/2
Vendimi për fillim me punë	03-1619/19 (10.11.2017)
Data akreditimit	21.03.2017

Përshkrimi i programit

Programi studimor administrimi publik është dizajnuar me qëllim që studentët, të cilët do të përfshihen në këtë program, të fitojnë njohuri menaxhimi, këshilluese, politike, analitike, njohuri juridike, shkathësi dhe kompetenca për punësimin e tyre në nivele më të larta të sektorit publik dhe joqeveritar.

Karriera

Studimet e administrimit publik mundësojnë plotësimin e nevojave arsimore në përkrahjen e studentëve në fillimin e karrierës së tyre profesionale në agjencitë qeveritare në nivel qendror dhe vendor, komuna, institucione publike, administratën e shkollave, organizata jofitimprurëse, universitete dhe ndërmarrje.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Ka njohuri të avancuara për teoritë e administrimit publik, hulumtimet dhe praktikat.
- Ka njohuri të dalluara për administrimin publik krahasimtar.
- Ka njohuri të thella për organizimin, funksionimin e administrimit publik të vendeve anëtare të BE.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Gjykon dhe jep mendim kritik për procedurat administrative.
- Planifikon dhe vepron efektivisht për administrimin dhe organizimin e shërbimeve publike.
- Tregon aftësi për vlerësim në lëmin e administrimit publik krahasimtar, duke i marrë parasysh aspektet etike dhe sociale dhe demonstroi vetëdijësim për aspektet etike në punë.
- E njih ndërlidhjen në mes proceseve administrative dhe veprimtarinë analitike të për nevojat e krijimit të politikave.

Aftësitë për të vlerësuar

- Gjykon dhe jep mendim kritik për procedurat administrative.
- Planifikon dhe vepron efektivisht për administrimin dhe organizimin e shërbimeve publike.
- Tregon aftësi për vlerësim në lëmin e administrimit publik krahasimtar, duke i marrë parasysh aspektet relevante shkencore, etike dhe sociale dhe demonstroi vetëdijësim për aspektet etike në punë.
- E njeh ndërlidhjen në mes proceseve administrative dhe veprimtarinë analitike të përvojat e krijimit të politikave.

Aftësitë e komunikimit

- Merr pjesë në debate publike dhe medime, duke shfrytëzuar fjalor përkatës në nivel profesional
- Shkruan, propozon dhe udhëheq projekte hulumtuese në lëmin e administrimit publik
- I shfrytëzon mjetet bashkëkohore për komunikim me teknologjinë bashkëkohore kur flitet për institucione të ndryshme.

Aftësitë e të mësuarit

- Është i aftë t'i identifikojë nevojat personale për studim autonom dhe këtë ta realizojë në mënyrë autonome në lëmin e administrimit publik krahasimtar.
- Mund t'i ndihmojë në trajnimin dhe zhvillimin e rasteve të veçanta në pozicionet administrative dhe ato të sektorit publik.
- Mund të tregojë aftësi për të dalluar modulet e klasifikimit të informatave, koncepteve dhe teorive të administrimit publik në politikën publike dhe administrimin publik.
- Mund të dizajnojë një mënyrë të re të punës në administratën publike në Maqedoni duke shfrytëzuar përparësitë krahasimtare.
- Ka aftësi për planifikim dhe organizim të funksionimit të administratës publike dhe institucioneve në përputhje me sistemet demokratike bashkëkohore.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [EMPS1030] [6.0 SETK] **Analiza e politikave publike**
- [MCPA01] [6.0 SETK] **Ekonomia në sektorin publik**
- [MCPA02] [6.0 SETK] **Baza teorike e administratës publike**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

Semestri 2

- [MCPA03] [6.0 SETK] **Politika rajonale dhe fondet strukturore të BE-së**
- [CMPA03] [6.0 SETK] **Administrata publike krahasimtare**
- [MCPA1041] [6.0 SETK] **Analiza cilësore dhe sasiore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

Semestri 3

- [MCPA1010] [6.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [MCPA3010] [6.0 SETK] **Kontrolli i administratës**
- [MCPA2020] [6.0 SETK] **Menaxhmenti financiar publik**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 4

- [MCPA4010] [30.0 SETK] **Punimi i magjistraturës**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Analiza e politikave publike**

Lënda ka për qëllim t'u mundësojë studentëve që ta përkufizojnë dhe ta ilustronë analizën e politikave dhe rolin e tyre në krijimin dhe transformimin e informatave relevante për politikën. Nuk ekziston pajtueshmëri me atë se si konkretisht dhe në mënyrë shumë precize të përkufizohet politika publike. Studentët do të kenë mundësi që të njihen me këtë fushë dhe në mënyrë kritike ta analizojnë zhvillimin dhe dukuritë në lëmin e politikave publike. Analiza e politikave publike është disiplinë për zgjidhjen e problemeve të cilat kërkojnë njohuri nga metodologjia dhe teoritë bazike të shkencave shoqërore, të profesioneve shoqërore dhe të filozofisë së politikave.

- **Ekonomia në sektorin publik**

Ekonomia në përgjithësi ndikon në atë se sa ne në mënyrë efikase kujdesemi për planetin tonë, për të ardhmen, pjesë e së cilës dëshirojmë të jemi, sa kujdesemi për burimet të cilat i kemi, deri në cilin nivel kujdesemi për të varfrit dhe të pasurit. Por duhet në mënyrë të veçantë të potencohet se parimet ekonomike dhe konceptet pa dallim të nivelit të zhvillimit ekonomik nuk ndryshojnë. Ekonomia në sektorin publik ka për qëllim të përkufizojë ekonominë dhe rolin e shtetit në ekonomi, rolin e institucioneve publike në ekonomi. Kjo ekonomi, po ashtu, ka për qëllim të përkufizojë ofertën dhe kërkesën agregate, ndikimin e politikës fiskale dhe monetare ndaj tregjeve.

- **Baza teorike e administratës publike**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të marrin një pasqyrë të qartë të koncepteve të rëndësishme për menaxhimin e institucioneve dhe praktikave të administratës publike. Theks i veçantë do të vendoset në natyrën dhe qëllimin e administratës publike, dhe teknikat e aplikimit të menaxhmentit.

- **Politika rajonale dhe fondet strukturore të BE-së**

Objektivat e lëndës: - të kuptohen rregullat dhe bazat për politikën rajonale të BE-së; - të përvetësohen njohuritë për instrumentet e politikës rajonale; - të aftësohen studentët për t'i kuptuar faktorët e zhvillimit rajonal; - të aftësohen për të krahasuar vlerën dhe efektet e zbatimit të politikës rajonale; - të aftësohen studentët për t'i analizuar marrëdhëniet e politikës kombëtare për fondet strukturore dhe rajonale të BE-së; - të aftësohen studentët për t'i identifikuar problemet rajonale në BE dhe të Maqedonisë; - ta kuptojnë rolin e politikës rajonale të BE-së;

- **Administrata publike krahasimtare**

Lënda është e strukturuar në atë mënyrë që përfaqëson hyrje në administratën publike krahasimtare. Ajo ka për qëllim që studenti të orientohet në strukturën, sjelljen dhe proceset e administrimit publik në perspektivën krahasimtare. Theks të veçantë do t'i vihet hulumtimit të rolit të sistemeve administrative në kuadër të kornizave më të gjera politike dhe demokratike në të cilat janë të vëna dhe funksionojnë. Vëmendja do të jetë e përkushtuar tek hulumtimi i sistemeve të veçanta administrative, me fokus në sistemet me demokraci liberale.

- **Analiza cilësore dhe sasiore**

Qëllimi i lëndës është fokusimi në dy qasje të përgjithshme të analizës së të dhënave, në atë sasiore dhe cilësore. Në aspekt të analizës sasiore fokusohet në përdorimin e analizës statistikore përderisa në aspekt të analizës cilësore përkufizohet çështje që nuk janë të përfshira në analizën sasiore - ose qasje të cilat nuk përdorin manipulime numerike. Po ashtu kjo lëndë do të analizojë dhe, nëpërmjet studimeve të rastit, do të prezantojë metodat e hulumtimit, pjesë nga hulumtimet shoqërore-shkencore, rezultatet e hulumtimit të dizajnit, të aplikimit dizajnit empirik si dhe të analizës multivariable.

- **Metodologjia e hulumtimit**

Kjo lëndë është e dizajnuar për studentët të cilët përgatiten për punimin e tezës së magjistraturës. Qëllimet kryesore janë që studentëve t'u ofrohen mjete për konceptualizimin e tezës së tyre me qëllim të gjetjes së çështjes së hulumtimit si dhe njohjen e metodave për mbledhjen e të dhënave përmes analizës sasiore dhe cilësore. Lënda është e fokusuar tek problemet e metodave dhe teknikave sasiore, siç është analiza statistikore, dhe të tekste që janë të lidhura me teorinë dhe testimin e hipotezave. Më pastaj të rëndësishme janë, po ashtu, edhe temat për interferencë deskriptive dhe kauzale, longitudinale, studime krahasimtare dhe studime të rasteve. Qëllimi është analiza e të dhënave cilësore, vënia finale e të gjitha praktikave teorike dhe veprave në funksion të dizajnit të shkrimit të temës.

- **Kontrolli i administratës**

Qëllimi kryesor i lëndës është që studentët të përfitojnë njohuri dhe informata për kontrollin dhe mbikëqyrjen, subjektet e kontrollit, llojet e kontrollit, procedurat për kryerjen e kontrollit, kontrollin e brendshëm dhe të jashtëm ndaj organeve të administratës shtetërore, kontrollin politik me të gjitha instrumentet juridike për realizimin e tij siç janë: pyetjet e deputetëve, interpelanca, votëbesimi i qeverisë, komisionet anketuese, realizimi i buxhetit si instrument i rëndësishëm politik për kontrollin juridik, kontrolli nga ana e prokurorit publik, avokati i popullit, kontrolli shoqëror,

kontrolli gjyqësor, kontrolli gjyqësor përmes procedurave administrative gjyqësore. Të gjitha këto institucione do të mësohen në aspektin krahasimtar.

- **Menaxhmenti financiar publik**

Qëllimi i lëndës është që studentëve t'ua prezantojë standardet dhe praktikën në punën financiare të grupeve organizative, metodat dhe shfrytëzimin e fondeve dhe teknikat tjera për administrimin dhe përgjegjësinë me punën financiare të OG-ve. Do të përfshihet këtu edhe vështrimi i analizave dhe aspekteve teknike në kontabilitet dhe interpretimi i raporteve financiare. Koncepti i shfrytëzimit efikas të burimeve paraqet bazën e parimeve dhe procedurave si dhe mundëson vendosje të kornizës racionale për alokim të burimeve. Lënda mundëson balancim përkatës në mes teorisë dhe praktikës, vështrim të të gjitha praktikave nga studime të ndryshme dhe është e dizajnuar në atë mënyrë që të zgjojë interesin e studentëve.

- **Punimi i magjistraturës**

Pas dhënies së provimeve, studenti mund të fillojë me procedurën e paraqitjes, së punimit dhe mbrojtjes publike të temës së magjistraturës. Studenti zgjedh mentorin, me udhëzimin e të cilit e përgatit aplikimin e tezës së magjistraturës. Aplikimi patjetër duhet të lejohet nga Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit. Pas punimit të versionit final të tezës së magjistraturës, Këshilli mësimor-shkencor formon komision tre anëtarësh, i cili përgatit raport, me çka pranohet ose refuzohet teza e magjistraturës. Raporti pozitiv miratohet nga Këshilli mësimor-shkencor dhe caktohet dita e mbrojtjes publike.

Lëndë zgjedhore

- **Menaxhimi i sektorit joqeveritar**

Në këtë lëndë do të hulumtohen teoritë dhe praktikën e menaxhimit përfshirë të menduarit strategjik dhe planifikimin strategjik si një kornizë. Ka të bëjë me çështje të rëndësishme të menaxhimit, duke përfshirë: kuadrin e strategjive të ndërtimit, lidhshirë, strukturën organizative dhe të projektimit, si dhe performancën. Lënda përfshin edhe përdorimin e studimit të rasteve të praktikave të menaxhimit në institucionet publike dhe të shoqërisë civile. Pjesë përbërëse e lëndës është edhe menaxhimi i ndryshimeve si pjesë e pashmangshme e menaxhimit dhe që kanë të bëjnë me dinamikën e ndryshimeve në mjedis, sidomos në aspektin e zhvillimeve politike, sociale, kulturore, ekonomike dhe teknologjike në Maqedoni dhe rajonin e E.JL.

- **Hartimi i politikave në BE**

Lënda ka për qëllim t'u mundësojë studentëve ta përkufizojnë dhe ta ilustrojnë analizën politikave dhe rolin e tyre në politikëbërjen e BE-së. Nuk ka ndonjë pajtim për mënyrën se si pikërisht të përkufizohet politika publike. Studentët do të kenë mundësi të njoftohen, me këtë fushë dhe ta analizojnë në mënyrë kritike zhvillimin, por dhe dukuritë në fushën e politikave publike. Krijimi dhe analiza e politikave publike është një disiplinë për zgjidhjen e problemeve që tërheq njohuri nga metodologjitë dhe teoritë themelore të shkencave shoqërore dhe të filozofisë së politikave.

- **Menaxhimi i projektit dhe vlerësimi i programeve në sektorin publik**

Qëllimi i lëndës është që studentët të njihen me teknikat për analizë të efektivitetit të organizatave në sektorin publik. Studentët do të përfitojnë shkathtësi për formulimin e pyetjeve për vlerësim, për seleksionimin e shembujve, planifikimin dhe mbledhjen e të dhënave, analizën e rezultateve të vlerësimit, dizajnimin e buxhetit për vlerësim, raportimin dhe komunikimin e rezultateve të vlerësimit tek palët e involvuara, zhvillimin e kompetencave për çështjet etike dhe politike të lidhura me vlerësimin.

- **Rregullimi juridik i administratës publike**

Përmes kësaj lënde studentët do të fitojnë njohuri në lidhje me marrëdhëniet e kornizës ligjore, relacioneve midis kornizës ligjore dhe procesit administrativ, në kompetencën e demarkacionit dhe dizajnimin e mekanizmave bashkëkohore për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të administratës publike, do të fitojnë njohuri të të drejtave dhe detyrimeve të tyre si të punësuar në sektorin publik.

- **Menaxhimi i dijes në sektorin publik**

Kuptimi dhe informatat nuk janë statike, por lëvizin nëpër organizata në forma të ndryshme. Një nga mënyrat për t'u bërë dallimi në mes udhëheqjen me dije dhe udhëheqjes me informata si dhe të identifikohen proceset dhe hapat të kyçur në të dyja polet. Lënda është e fokusuar tek planet dhe aktivitetet të cilat duhet t'i kryejnë dhe t'i kontrollojnë shënimet respektivisht informatat e organizatës. Këto aktivitete përbëhen nga strategjitë dhe praktikën për identifikimin, krijimin, përfaqësimin dhe përvetësimin e rishikimit dhe përvojave. Rishikimi dhe përvoja përmbajnë njohuri, por gjenden te individët ose janë të ndërtuara në proceset dhe praktikën organizative të tyre.

- **Menaxhimi dhe optimizimi i burimeve publike**

Në fund të semestrit studentët duhet: • Të aplikojnë perspektiva teorike në problemet praktike në fushën e burimeve njerëzore; • Ta kuptojnë rolin e BNJ në zhvillimin organizativ; • Ta shpjegojnë rolin e MBNJ në vëzhgimin e zhvillimit dhe ndikimit në arritjen e objektivave të organizatës; • T'i analizojnë dhe t'i përkufizojnë vendet e punës për funksionim më efikas të organizatës; • Ta përkufizojnë mjedisin si një grup i institucioneve, forcave dhe faktorëve; • T'i identifikojnë boshllëqet në burimet njerëzore.

- **Retorika**

Retorika, përgjatë historisë së vet prej mbi 2500 vjeçare, retorika shfrytëzohet për shënjimimin e shumë gjërave, por sot me retorikë kuptojmë artin e bindjes nëpërmjet të gjuhës. Retorika shënon mënyrën në të cilën një individ ndërlidhet me një ide apo një ide me qëllim ta bindë tjetrin. Retorika karakterizohet me disa tipare kryesore dalluese. E përkufizon qendrën nga e cila, kjo lëmi, zbulohet. Retorika më së pari l përkufizon situatat e caktuara tipike të të folurit.

- **Multilingualizmi dhe multikulturalizmi**

Qëllimi i kësaj lënde është shqyrtimi i shumëgjuhësisë në shoqëritë multikulturore, si fenomen social. Ky fenomen është masiv në mbarë botën. Gjatë ligjëratave në mënyrë më të thuktë do të shqyrtohen termat: monokulturalizëm, shumëkulturalizëm, multikulturalizëm. Do të sqarohet nocioni nacionalizmi lingvistik, ku do të theksohet se të paktën ka dy forma të këtij nacionalizmi, ku njëra formë përplasat me tjetrën: për udhëheqësit e vendeve më të fuqishme nacionalizmi ka domethënien e zgjerimit, kurse për pakicat ai merr formën e rezistencës dhe të luftës për afirmimin e identitetit, përballë një presionit të tillë. Vend të shquar në program do të ketë edhe multikulturalizmi në arsim. Në shkollë për multikulturalizmin angazhohen për programe mësimore që përfshijnë përmbajtje që u përkasin kulturave të ndryshme.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet e TI për përpilimin e një punimi shkencor**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'ua tregojë studentëve elementet teknike, struktura e tekstit dhe dizajni i një punimi shkencor. T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri më të thelluara dhe shkathtësi nga kapitujt e zgjedhur të aplikacioneve TI që do t'u duhen për përpunimin e punimeve shkencore e profesionale. Zbatimi praktik i këtyre objektivave, gjatë përpunimit të punimit individual shkencor.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet për përpunimin statistikor të të dhënave**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'u tregohen studentëve elementet teknike nga lëmi i statistikës: organizimi, përpunimi, krahasimi përmes analizave dhe publikimi i të dhënave. T'u mundësojë studentëve të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi më të përparuara nga kapitujt e zgjedhur të avancuar të aplikacioneve për përpunimin statistikor të të dhënave. Zbatimi praktik i këtyre objektivave në përpunimin statistikor të të dhënave të marra nga pyetësorët, kontributet, studimet shkencore dhe dokumentet tjera.

- **Komunikimi profesional**

Lënda fokusohet në zhvillimin e atyre shkathtësive të komunikimit që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale. Studentët do ta mësojnë procesin e analizimit të një shumëllojshmërie situatash të komunikimit dhe t'u japin përgjigje adekuate po atyre. Ndër temat që do të përfshihen janë: komunikimi në organizata, komunikimi ndërpersonal dhe grupor, prezantimet gojore, intervistat për punësim, letrat profesionale të biznesit, si dhe shkathtësitë ndërpersonale, duke përfshirë dinamikën e grupit dhe punën ekipore.

- **Tregu i punës**

Qëllimi kryesor i lëndës "Tregu i punës" është t'i pajisë studentët e studimeve të ciklit të dytë me njohuritë bazë dhe njohuritë e thelluara në fushën e teorisë të tregut të punës, pastaj me mekanizmin e funksionimit të tij në ekonominë e tregut. Lënda "Tregu i punës" ka si mision t'u ofrojë dhe t'u mësojë studentëve kategoritë, ligjet dhe parimet kryesore me të cilat funksionon tregu i punës. Lënda u bën një analizë të hollësishme mënyrës së sjelljes dhe rolit që luajnë agjentët kryesorë të tregut të punës: individëve, firmave dhe qeverisë. Analiza mbështetet në dy kategoritë themelore: të kërkesës për punë dhe të ofertës së punës, të cilat gjejnë aplikim pothuajse në të gjitha temat që trajtohen në këtë lëndë. Njohuritë e përfituara nga studentët në këtë lëndë shërbejnë si bazë teorike themelore e domosdoshme për të kuptuar e përvetësuar teorinë dhe politikat e ndryshme që aplikohen në tregun e punës. Lënda synon që studentët të kuptojnë se si tregjet e punës shpërndajnë dhe përdorin në mënyrë efikase faktorin e rrallë të prodhimit, punën. Leksionet përfshijnë njohuri të koncepteve të kërkesës për punë e të ofertës së punës dhe aplikimit të tyre praktik; sjelljen e individëve në tregun e punës për të maksimizuar dobishmërinë e tyre; sjelljen e firmave në tregun e punës që synojnë maksimizimin e fitimit; rolin e qeverisë në tregun e punës, strukturat e ndryshme të tregjeve të punës: tregu i punës në konkurrencë të plotë, monopoli në tregun e punës, monopsoni në tregun e punës, roli i sindikatave në tregun e punës, monopoli bilateral në tregun e punës. Leksionet dhe diskutimet në klasë mbulojnë materiale të cilat mund të mos jenë në libër dhe disa aspekte të materialeve që përfshihen në librin bazë

nuk do të diskutohen në klasë, por i lihen studimit aktiv te studentit. Prandaj studentit, për të garantuar suksesin në përvetësimin sa më të mirë të lëndës, duhet të jetë i pranishëm në leksion dhe seminar duke marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutimin e problemeve të ndryshme që lidhen me tregun e punës.

- **Metodologjia e mësimdhënies**

Qëllimi i lëndës është t'i njoftojë studentët me qasjet themelore dhe metodat e mësimdhënies. Pritet që studentët të fitojnë njohuri dhe shkathtësi për përdorim të mjeteve për mësimdhënie aktive. Gjithashtu, lënda ofron qasje ndaj zhvillimit, mësimdhënies dhe të nxënies si koncepte, si dhe ndaj normave themelore të cilat mësimdhënësve do t'u mundësojnë të ligjërojnë mbi zhvillimin e mendimit. Përmes kësaj lënde, studentët do të përfitojnë bazë teorike dhe strategji, me çka do të mund ta zhvillojnë të menduarit e tyre kritik, si dhe të menduarit kritik të studentëve.

- **Filozofia e shkencave shoqërore**

Kjo lëndë përfshin pajisjen e studentëve me informata që do t'u mundësojnë atyre përfitimin e diturive, shkathtësive dhe kompetencave në shkencat shoqërore, përfshirë metodologjinë e punës (sqarim, teoretizim, testim), aplikim të filozofisë (në veçanti individualizmi kundrejt kolektivizmit), natyra e racionalitetit, si dhe historia e teorive dhe koncepteve. Ky modul ofron studim të avancuar të debateve aktuale lidhur me ontologjinë, metodologjinë dhe synimet e shkencave shoqërore. Lënda do të përqendrohet në çështjet qendrore të shkencave shoqërore: etno-metodologjia, evolucioni, fenomenologjia, racionaliteti, relativizmi, metodat shkencore, interpretime tekstuale. Rezultat e të mësuarit: Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Ta kuptojnë qëllimin e shkencave shoqërore si dhe dallimin në mes të të sqaruarit dhe të kuptuarit të sjelljes njerëzore. T'i sqarojnë qasjet e ndryshme në shpjegimin e shkencave shoqërore në krahasim me shkencat shoqërore, specifikat e të qenit qenie njerëzore dhe fenomenet sociale. T'i kuptojnë strukturat sociale, praktikat, normat institucionet etj. si dhe relacionet në mes individëve dhe strukturave më të gjera shoqërore. Ta sqarojnë mbështetjen jo vetëm në fakte për individët dhe gjendjet e tyre mentale, por gjithashtu edhe rastet në të cilat fenomenet shoqërore nuk mundet të sqarohen përmes sjelljeve individuale.

- **Menaxhimi i projekteve**

Me përfundimin e suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Të planifikojnë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e projektit, të identifikojnë ndërvarësitë e tyre, kohëzgjatjen si dhe kostot e tyre; Të përgatisin raportet e nevojshme dhe të kryejnë të gjitha komunikimet e nevojshme ndërmjet projektit dhe klientit, si dhe në mes të anëtarëve të ekipit dhe të aktorëve të tjerë; Të strukturujnë projektin dhe aktivitetet e tij përbërëse; Të përgatisin një Gantt-tabelë dhe një plan të rrjetit për projektin dhe të identifikojnë kohën më të shkurtër të nevojshme për të përfunduar projektin; Të përdorin MS Project si një mjet në procesin e planifikimit, zbatimit dhe rishikimit të projektit; Të përcaktojnë projektin, të identifikojnë lëminë dhe objektivat e tij, si dhe të zhvillojnë specifikat e projektit;

- **Metodat e optimizimit**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i prezantojë teknikat e modelimit dhe të optimizimit me qëllim të aftësisë të studentëve në zhvillimin e modeleve të cilat shfrytëzohen për zgjidhjen e problemeve reale në lëmin e shkencave kompjuterike. Në mes tjerash kjo lëndë ka për qëllim ta analizojë rëndësinë e faktorizimit matricor si një mjet shumë i rëndësishëm që ofron modalitete për optimizimin e zgjidhjes së algoritmeve të ndryshme numerike me interes bazik për zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga sfera e shkencave kompjuterike. Nëpërmjet kësaj lënde studentët do të kenë mundësi t'i mësojnë teorinë bazike të optimizimit edhe metodat për caktimin e optimumit. Do të analizohen metodat e ndryshme të optimizimit sikurse që është simpleks metoda, problemi i dualitetit si dhe sensitiviteti i problemeve të programimit linear. Qëllimi, po ashtu, është analiza e zbatimit kompjuterik të secilit problem të analizuar duke ofruar edhe modelin përkatës për optimizim.

- **Çështjet etike dhe e drejta në teknologjitë e informacionit (TI)**

Qëllimet e lëndës: Të zhvillon kuptueshmërinë për gjendjen reale në relacionet mes kompjuterëve, ndryshimeve të teknologjisë, shoqërisë dhe ligjit; Të vejë në pah rolin e fuqishëm që kompjuterët dhe profesionistët e kompjuterëve kanë në shoqërinë e teknologjisë; Të ofron të kuptuarit e çështjeve legale që janë relevante për lëminë e kompjuterizimit; Të ofron të kuptuarit e koncepteve etike që janë me rëndësi për shfrytëzuesit e kompjuterëve dhe profesionistët; Të kontribuon në arritjen e eksperiencës së nevojshme në shqyrtimin e çështjeve etike dhe zgjidhjen e dilemave etike.

- **Mbrojta e të drejtave të njeriut**

Qëllimi i kësaj lënde është: të njoftohen studentët me konceptin e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, zbatimin e këtyre të drejtave në praktikë, ndikimin e tyre në krijimin e politikave nacionale, të nxiten studentët të mendojnë në mënyrë kritike për raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe asaj nacionale, të vetëdijësohen për ngjarjet aktuale ndërkombëtare, si ndikojnë ato në jetën e përditshme të njerëzve në botë, ti nxisë studentët ta japin kontributin e tyre në sferën e përgatitjes së ligjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me shpresë se ata që sjellin

vendime do i marrin parasyshë në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikave shtetërore.